

SPECIFIKIME TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Materialet qe duhet te kete vrojtuesi i plazhit ne kulle vrojtim: radio komunikimi, flamuj sinjalizues (Jeshil,Portokalli,Kuq), bove shpetimi, dylbi , bilbil, kuti e ndihmes se shpejte.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Vrojtuesi i plazhit ka si detyrim:

- a) të ketë njohuri për kuadrin ligjor të funksionimit të stacionit të plazhit, teknikat e shpëtimit dhe dyluftimit në ujë, dhënien e ndihmës së parë mjekësore, për hidrometeorologjinë, karakteristikat e brigjeve shqiptare dhe rrymat ujore në to, si dhe mbi sigurinë e mjedisit ujor me referim të veçantë për të njohur faktorët e rrezikshëm që mund të jenë të pranishëm në ujë;
- b) të jetë i angazhuar ekskluzivisht në shërbim të vrojtim-shpëtimit dhe të jetë i pranishëm përgjatë gjithë kohës pranë pikës së vrojtimit, përjashtuar rastet emergjente;
- c) të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyrë të kuqe gjatë shërbimit. Uniforma ka të shkruar në pjesën e përparme logon, në krahun e majtë, simbolin e flamurit shqiptar, në krahun e djathtë numrin e matrikullës dhe, në pjesën e pasme, në mënyrë të dukshme qartë, “Vrojtues plazhi” dhe “Lifeguard”;
- ç) të sinjalizojë pranë organeve kompetente në rastet kur verifikohen kundërvajtje në territorin e stacionit të plazhit dhe në hapësirën ujore përballë tij;
- d) të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit dhe të bëjë zëvendësimin e materialeve të konsumuara në kutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të mbajë në efikasitet mjetet e shpëtimit;
- dh) të ketë certifikatën dhe kartën ekuivalente të certifikatës brenda afatit të vlefshmërisë, lëshuar nga qendra e formimit profesional përkatës. Rinovimi i saj bëhet sipas rregullores së subjektit certifikues, me qëllim monitorimin e aftësive fizike, mendore të vrojtuesit.

Shërbimi i vrojtuesve te plazhit publik, ne objektet si me poshte:

- Vrojtues Plazhi Publik Çentrali Sarande , me sherbim te plote 14 ore, nga ora 06.⁰⁰-20.⁰⁰
- Vrojtues Plazhi Publik Hasan Tahsini Sarande, me sherbim te plote 14 ore, nga ora 06.⁰⁰-20.⁰⁰
- Vrojtues Plazhi Publik Plazhi i ri te Zadra e notit Sarande, me sherbim te plote 14 ore, nga ora 06.⁰⁰-20.⁰⁰
- Vrojtues Plazhi Publik Plazhi Pllakat lagja nr.4 Sarande , me sherbim te plote 14 ore, nga ora 06.⁰⁰-20.⁰⁰
- Vrojtues Plazhi Publik zona e Marines ish reparti ushtarak Ksamil , me sherbim te plote 14 ore, nga ora 06.⁰⁰-20.⁰⁰

Kërkesat për zbatimin e shërbimit:

- Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me certifikate perkatese të lëshuara nga Federata Shqiptare vrojtuesit e plazhit dhe shpetimit ne uje.
- Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga AK dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre.
- Vrojtuesit duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit , radio komunikimi,flamuj sinjalizues, bove shpetimi, dylbi , bilbil, kuti e ndihmes se shpejte.
- Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta: a-Rregullorja e brendshme b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit. c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
- Numrat telefonik të Policisë, Zjarrëfikseve, Urgjence.
- Objektivat:
 - Të monitoroje dhe ruajë pushuesit me qellim ruajtjen e jetes se tyre pergjate plazhit publik gjate notimit, per periudhen e sezonit turistik.
- Detyrat:

- Detyrat e kontraktorit: Kontraktori ka për detyrë: Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t'ja paraqesë Autoritetit Kontraktor. Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn. Të ndërhyjë me, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja me qellim sigurinë e jetes se pushuesve dhe të bashkëpunojë me Policinë e shtetit, Policinë Bashkiake dhe Urgjencen spitalore.

- Punonjësi i shërbimit ka për detyrë: - Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit. - Te vendos flamujt sinjalizues sipas motit kur lejohet notimi ose jo. Të kontrollojë masat e sigurisë në det si sinjalisteken ujore te vendosur si kufizim per notuesit, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjësën e tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.

- Para marrjes së shërbimit, kontrollon kullen e vrojtimit, bazen materiale si flamuj sinjalizues,bove shpetimi,dylbi,bilbil,kuti e ndihmes se shpejte në prezencë të vrojtuesit dorezues dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të subjektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.

Afatet e ekzekutimit:

Numri i Kullave te vrojtimit	Numri i turneve	Numri i vrojtuesve te nevojshem	Numri i diteve ne total	Afati i ekzekutimit
5	2 turne sherbimi	12	93	13 Qershor deri 15 Shtator

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera ne leke 1 vrojtues/dite	Vlera ne leke 1 kulle vrojtimi/dite
1	Shpenzime per pagen baze		
2	Sigurime shoqerore 16.7%		
3	Vjetersi 1%/vit		
	Vlera totale pa tvsh 1 kulle/dite		
	Vlera totale me tvsh 1 kulle/dite		

Komisioni

Eljon Mahmutaj

Anila Vjeri

Ana Mitro